

Shqipëria në arkivat gjermane: Fondet arkivore, përdorimi dhe veçoritë e këtij dokumentacioni

Albania and the Albanian questions in the German archives. Some guidelines on the documents, premises and the use of the German Archives.

Abstract: *German archives treasure a large number of documents on Albania and the Albanian questions, especially from the 20th century. All documents are classified according to the fields, the reporting bodies, and the years.*

Such documentation mainly resides in the Political Archive of Auswärtiges Amt – Ministry of the Foreign Affairs in Berlin, in the Military Archive in Freiburg and in the Federal Archive. The following paper describes and gives information about these archives; how, where and what documents scholars can work on, etc.

In order to illustrate the data, the author also reproduces a few documents reflecting the paramount importance of the German archives to Albanian history. They throw precious light on little-known aspects of the relationship between the two countries.

Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme Berlin - Politisches Archiv des Auswärtigen Amts

Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme Berlin (PA AA) përbën një rast të veçantë ndër arkivat e tjerë shtetërore në Gjermani. Në këtë arkiv ruhen dokumentet e vetëm një institucioni, Ministrisë së Punëve të Jashtme gjermane (*Auswärtiges Amt*), ndërkohë që gjithë institucionet e tjera shtetërore, si në kohën e Rajhut gjerman, ashtu edhe pas lufte, institucionet federale e dorëzojnë dokumentacionin e tyre në arkivin e shtetit (quhej *Reichsarchiv* deri në 1945 dhe *Bundesarchiv*, pas Luftës së Dytë Botërore). Një ndër arsyt kryesore që mbështet këtë veçori është fakti që, politika e jashtme është një proces i gjatë dhe historik dhe „shpesh gjatë marrjes së vendimeve politike, Ministrisë së Punëve të Jashtme i duhet të konsultohet me dokumentacionin e vjetër arkivor“.¹ Në fakt, kjo është një përvojë e zakonshme që e aplikojnë edhe shumë vende të tjera. Kësaj përvojë do t'i bashkohej edhe Shqipëria, kur në fillimvitet 2000 u krijua

1 Ludwig Biewer: Das Politische Archiv des Auswärtigen Amts, Edition Diplomatie, Berlin 2011, f. 6 [Botim i Ministrisë së Punëve të Jashtme Berlin].

Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme, në të cilin është grumbulluar dokumentacioni kryesor arkivor për politikën e jashtme të shtetit shqiptar, qysh nga krijimi i tij.

Në këtë kuadër, PA AA është i përfshirë në strukturën organizative të Auswärtiges Amt-it me emërtimin Referati 117 „Arkivi Politik dhe Shërbimi Historik“. PA AA ka prej vitit 2011 një sallë të re leximi, me rreth 32 vende pune dhe përdoret mesatarisht prej afro 1000 përdoruesve të gjitha llojeve, prej të cilëve, sipas një statistike të vitit 2011 rreth 40% janë studiues të huaj.² Çdo vit, ky arkiv vendos në dispozicion të studiuesve rreth 48.500 dosje, ku nuk janë të përfshira dosjet që kërkohen nga Ministria e Jashtme për përdorimin e tyre të brendshëm.

Parimisht dokumentet konsultohen nga studiuesit në origjinal. Por, nëse dokumentacioni i kërkuar është filmuar, për arsye sigurie jepet kopja. Po ashtu, një pjesë e konsiderueshme e fondeve të paraviteve 1945 është digjitalizuar nga aleatët pas Luftës së Dytë Botërore dhe mund të konsultohet edhe në US-Nationalarchiv [www.nara.gov].

Në fondin arkivor të PA AA gjenden rreth 26 km dokumentacion arkivor, i ndarë në 370.000 dosje me mbi 150 milionë faqe, ku thuhet një e treta e këtij fondi i përket periudhës 1860-1945.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, për një kohë të gjatë, arkivat gjermane në Berlin, përfshi edhe atë Ministrisë së Punëve të Jashtme, nuk u evakuuan. Së pari me fillimin e bombardimeve masive mbi qytetin e Berlinin në marsin e vitit 1943, ku u dëmtua rëndë edhe godina e Auswärtiges Amt-it, filloi transferimi i fondeve arkivore drejt lindjes, si edhe në bodrume të disa kështjellave të vjetra në Harz³. Gjatë përparimit të Ushtrisë së Kuqe në territorin gjerman, fondet arkivore u shpërngulën përsëri. Gjatë transportit, si pasojë e bombardimeve u dëmtuan rëndë fondet e politikave tregtare ku, ndër të tjera, një kamion transporti i ngarkuar me dokumente sekrete të periudhës së Weimar-it si edhe me një pjesë të konsiderueshme të fondit të sektorit të Kulturës u dogj plotësisht. Po ashtu, një pjesë e madhe e këtyre fondeve arkivore humbi nga lëvizjet e shpeshta të dokumentacionit si edhe nga abuzimi i punonjësve të arkivave.

Fundi i Luftës së Dytë Botërore e gjeti këtë dokumentacion arkivor në zonën e pushtimit amerikan. Pas lufte, arkivi i kapur u dërgua me avion në Whaddon Hall në Buckinghamshire në Britaninë e Madhe, ku u filmua edhe pjesa më e madhe e fondeve. Në vitin 1956, pas një marrëveshje të qeverisë së Bonit me fuqitë fituese të luftës, filloi rikthimi i fondeve arkivore, i cili përfundoi plotësisht në vitin 1959. Kushti i vënë nga Aleatët ishte që, këto

2 Po aty, f. 9.

3 Masivi malor më i lartë në Gjermaninë Veriore që shtrihet ndërmjet landeve Niedersachsen, Sachsen-Anhalt dhe Thüringen. [Shën. im]

fonde, të bëheshin të përdorshme për kërkimin shkencor ndërkombëtar.⁴

Fondin bazë dhe njëherazi fondin e parë të këtij arkivi qysh prej krijimit, e përbën dokumentacioni i Departamentit Politik (*Abt. IA*), me rreth 20.000 vëllime dosjesh të viteve 1867-1919. Në këtë fond gjenden mbi 11.000 faqe dokumente për Shqipërinë, të cilat hedhin dritë mbi historinë e Shqipërisë deri në vitin 1920.

Bazuar në një ristrukturim të *Auswärtiges Amt*-it pas Luftës së Partë Botërore, në vitet 1920-1936 përkrah Departamentit të Personelit dhe Administratës (I) u shtua edhe Departamenti Juridik (V) dhe Departamenti i Kulturës (VI) dhe, prej vitit 1922 u shtuan po ashtu edhe tre Departamente Vendesh (II-IV), ku trajtoheshin çështjet politike, ekonomike dhe kulturore të vendeve të huaja. Në fondet arkivore për Shqipërinë, të trashëguara nga fondet e këtyre Departamenteve, janë rreth 6000 faqe dokumentacion për Shqipërinë.

Me shtimin e departamenteve në Ministrinë e Jashtme, u krijuan edhe një sërë zyrash të tjera lidhëse ndërmjet Departamenteve dhe Ministrit të Jashtëm, siç ishin Zyra e Ministrit të Rajhut (*Büro RM*) dhe Zyra e Sekretarit të Shtetit (*Büro StS*). Dokumentacioni i grumbulluar nga këto zyra tregon jo vetëm mënyrën si vihej në dijeni e njoftohej Ministri i Jashtëm, ato reflektojnë njëherazi edhe trajtimin e çështjeve më të rëndësishme të politikës së jashtme gjermane, por edhe të vendeve të tjera, si në kuadër bilateral, ashtu edhe multilateral.

Njohja e strukturës të *Auswärtiges Amt*-it është e rëndësishme, sepse siç edhe shihet më sipër, fondet arkivore sot, janë të ndara pikërisht sipas emërtimeve të fondkrijuesve.

Përkrah dokumentacionit të qendrës, në PA AA është grumbulluar edhe Fondi i Përfaqësive Diplomatieke të Rajhut Gjerman deri në vitin 1945, pjesë e të cilit është edhe Fondi i Legatës dhe Konsullatës së Përgjithshme në Tiranë në vitet 1923-1944. Ky fond ka mbi 5000 faqe dokumente dhe përbën kështu gati 1/10 e gjithë dokumenteve mbi Shqipërinë që gjenden në këtë arkiv. Në total, në arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme gjermane në Berlin, gjenden mbi 56 mijë faqe dokumente, të cilat hedhin dritë mbi historinë e Shqipërisë.

Spektri i këtyre dokumenteve është gjithëpërfshirës duke filluar nga raportet mbi politikën e brendshme të shtetit shqiptar në periudhën e Republikës e më pas të Monarkisë, mbi ekonominë si edhe politikën e jashtme. Këtu vlen të theksohet se, më me vlerë paraqiten raportet politike të Legatës gjermane për marrëdhëniet shqiptaro-italiane, shqiptaro-jugosllave etj. Këto raporte jo vetëm që japin në mënyrë të detajuar

4 <http://www.archiv.diplo.de/Vertretung/archiv/de/05-Ueber-das-Archiv/5-1-geschichte.html>, datë 20.11.2017. [Faqja zyrtare e internetit e Arkivit Politik të Ministrisë së Punëve të Jashtme gjermane].

zhvillimin e këtyre marrëdhënieve, por po ashtu ato hedhin dritë edhe mbi figurën e Ahmet Zogut dhe politikën e tij të ndjekur ndaj Italisë. Po kaq me rëndësi në këto dokumente paraqiten edhe vlerësimet që ministrat gjermanë në Tiranë u bëjnë personaliteteve shqiptare të kohës. Me vëmendje diplomacia gjermane ndiqte edhe jetën parlamentare shqiptare. Shembull tipik për këtë gjë është ekzistenca në fondet e këtij arkivi e raportit të Komisionit Hetues Parlamentar mbi veprimet e ish Ministrit të Financave dhe zv/ Ministrit të Punëve të Jashtme Myfid Bej Libohovës në Nëntor të vitit 1925.

Fondet e thuajse 300 përfaqësive gjermane janë të madhësive të ndryshme dhe thuajse të plota. Ajo që bie në sy gjatë vlerësimit të këtyre fondeve është fakti që, krahasuar me shtete të tjera të vogla apo vende në të cilat Gjermania e këtyre viteve nuk kishte ndonjë interes strategjik, fondi i Legatës gjermane në Tiranë me një numër mbi 5000 faqe dokumente është relativisht i konsiderueshëm.

Shumë përfaqësi diplomatike gjermane, gjatë luftës e asgjësuan arkivin e tyre, që ai të mos binte në duart e kundërshtarit. Kjo gjë ka ndodhur edhe në Shqipëri, kur vetë konsulli gjerman Martin Schliep shkruan se, pas kapitullimit të Italisë në vjeshtën e vitit 1943, ai e dogji arkivin e përfaqësisë, nga frika se mos dokumentacioni binte në duart e italianëve.

Një nga risitë që sjell studimi i këtyre fondeve arkivore është vendosja e marrëdhënieve diplomatike shqiptaro-gjermane dhe hapja e përfaqësive përkatëse diplomatike. Ky trajtim është i rëndësishëm edhe për faktin se, duke vlerësuar problematikën e hapjes së legatës shqiptare në Berlin, jemi në gjendje të hedhim dritë mbi funksionimin e shtetit shqiptar në vitet 1923-1939 si edhe në organizimin e politikës së jashtme të qeverive shqiptare në këto vite.

Meqenëse Gjermania e hapi përfaqësinë e saj diplomatike qysh në vitin 1923, presidenti e më pas mbreti Zog, po ashtu e vlerësoi të nevojshme hapjen e një përfaqësie reciproke në Berlin.

Burimet arkivore që flasin mbi hapjen e një legate shqiptare në Berlin datojnë në gjysmën e dytë të vitit 1927. Problematika që shfaqte hedhja e një hapi të tillë politik e diplomatik nga Zogu dhe qeveria shqiptare ndahet në dy periudha:

Periudha e parë, nga viti 1927 deri në vitin 1934, hedh dritë mbi mënyrën e organizimit dhe drejtimit të shtetit shqiptar në këto vite. Duke u bazuar në ndryshimet e shpeshta të vendimeve politike për hapjen e përfaqësisë shqiptare në Berlin, por edhe në ndërrimin e shpeshtë të kandidaturave që duhej të drejtonin këtë përfaqësi, dallohet qartë mënyra qeverisëse dhe vështirësitë që ndeshte Zogu në krye të shtetit shqiptar. Diskutimet mbi zgjedhjen e ministrit shqiptar kryheshin shpesh në formën e thashethemeve, ashtu siç ishte edhe në traditën orientale

që karakterizonte një pjesë të mirë të elitës drejtuese shqiptare. Në këtë kuadër, brenda një harku të shkurtër kohor, u përfolën një sërë emrash që duhej të merrnin këtë post, duke filluar nga Faik Konica, Eqrem Bej Vlora, Çatin Saraçi, Jak Koçi etj. Mbetet për t'u vlerësuar fakti që, në vitin 1927 Zogu mendonte të tërhiqte Faik Konicën nga Uashingtoni-i dhe ta vendoste atë në krye të diplomacisë shqiptare në Berlin.⁵

Kjo përfaqësi e re do të përkujdesej edhe për mbarëvajtjen e marrëdhënieve diplomatike me Vjenën dhe Bernën. Në vitin 1929, si pasojë e ndërhyrjes së konsullit shqiptar në Vjenë, Çatin Saraçi, Zogu heq dorë nga hapja e Legatës në Berlin. Tashmë filloi të diskutohej për shndërrimin në Legatë të konsullatës shqiptare në Vjenë, e cila do të kujdesej edhe për mbarëvajtjen e diplomacisë shqiptare me Gjermaninë, Çekosllovakinë dhe Hungarinë.⁶

Ky vendim mund të shpjegohet së pari nëpërmjet pengesave që shkaktonte Legata Italiane në Tiranë, si nëpërmjet politikës së saj, ashtu edhe nëpërmjet propagandës që ajo bënte përmes njerëzve të saj të besuar. Në këtë kohë Italia i trembej ndërhyrjes së biznesit gjerman në Shqipëri. Së dyti, ky ndërrim i shpeshtë vendimesh ishte tipik për mënyrën qeverisëse të Zogut, pasi siç shprehej ministri gjerman në Tiranë *“për Zogun nuk është vendimtare se ç’ thotë, por ç’ bën”*.⁷ Së treti, duke parë mekanizmat mbi të cilat e kishte ndërtuar pushtetin e tij Zogu, nisur edhe nga kompleksiteti i ndërtimit të shoqërisë shqiptare dhe gjendjes ku ajo ndodhej, atij i duhej të mbante një ekuilibër midis dashamirësve e përkrahësve dhe kundërshtarëve të tij.

Në përzgjedhjen e vendit të hapjes së Legatës shqiptare në Berlin për Evropën Qendrore shfaqen qartë kontradiktat dhe pikëpamjet e ndryshme të politikës shqiptare. Për qeverinë shqiptare Berlini jo vetëm që konsiderohej si qendra e diskutimit të çështjes aq të rëndësishme të minoriteteve shqiptare, por mendonte se ndaj Gjermanisë duhej të tregohej korrektësi edhe për faktin se, Gjermania në ndryshim nga disa shtete evropiane kishte disa vjet që kishte çelur në nivel legatë misionin e saj diplomatik në Tiranë. Përballë këtyre të fundit qëndronte një grup deputetësh shqiptarë, të cilët, sipas Ministrit gjerman, kërkonin të favorizonin Vjenën për arsye të mirëfillta përfitimesh personale.⁸

Periodha e dytë dhe më intensive e hapjes së përfaqësisë shqiptare në Berlin shtrihet në periudhën 1934-1938.

Nisur nga zhvillimet në vend, në shkurt 1934, mbreti Zog mori

5 PA/AA, ADG, PIII, Karton 1, Band 1, 1924-1939. Raport i Kardoff-it drejtuar Ministrisë së Jashtme Gjermane, Nr. 956, datë 5.08.1927.

6 PA/AA, ADG, PIII, Karton 1, Dokumenti Nr. 206.

7 PA/AA, ADG Tirana, PIII, Karton 1, Dokumenti Nr. 875, datë 08.08.1929).

8 PA/AA, ADG, PIII, Karton 1, Dokumenti Nr. 206.

vendim për të forcuar marrëdhëniet e Shqipërisë me Rajhun gjerman. Ky bashkëpunim duhej të fillonte me hapjen e një legatë të përbashkët për Gjermaninë, Austrinë dhe Hungarinë me selinë e saj kryesore në Berlin. Për nga rëndësia kjo legatë do të ishte e barasvlershme me atë të Parisit dhe tashmë Zogu ishte gati që, për përzgjedhjen e Ministrit shqiptar të pranonte edhe propozime nga qeveria gjermane. Ky propozim mund të konsiderohet si një lëvizje e zgjuar e Zogut, duke pasur parasysh se një nga pengesat serioze për hapjen e Legatës në Berlin kishte qenë pikërisht loja intriguese e klaneve të ndryshme pranë tij për marrjen e drejtimit të misionit diplomatik.

Meqenëse qeveria shqiptare ndodhej në vështirësi ekonomike, Zogu vendosi të mbyllte përfaqësitë shqiptare në Ankara dhe Sofje. Veprimtaria në këto shtete do të mbulohej nga përfaqësitë diplomatike të Athinës dhe Beogradit.⁹ Zogu e mori këtë vendim më 12 shkurt 1934, pra dy ditë pas nënshkrimit së Paktit Ballkanik në Athinë, duke dashur kështu të forcojë lidhjet e Shqipërisë me shtetet e Evropës Qendrore si kundërpeshë ndaj këtij Pakti. Por, Berlini do të mbante një qëndrim të ftohtë në lidhje me këtë projekt sepse qeveria gjermane nuk donte të bëhej palë në këtë demonstrim politik të Zogut. Një problem tjetër për qeverinë gjermane paraqiste edhe mbyllja e përfaqësive diplomatike shqiptare në Ankara dhe Sofje. Ajo nuk donte që ky veprim i qeverisë shqiptare t'i faturohej Berlinit. Ndër të tjera *“për qeverinë gjermane nuk ishte e këndshme që korpusi i tejfryrë diplomatik të zgjerohej edhe me një legatë të vogël ekzotike”*.¹⁰

Hapja e legatës shqiptare në Berlin shikohej si rrezik edhe nga Italia, e cila i trembej një afrimi të mundshëm të Zogut me qeverinë gjermane. Kështu që, ambasadori italian në Berlin, Cerutti-n, protestoi në Berlin kundër hapjes së kësaj legatë, çka mjaftonte që, përkrah problemeve që u renditën më sipër, Berlini të udhëzonte ministrin gjerman në Tiranë Luckwald të mos jepte një përgjigje të qartë ndaj kërkesës shqiptare dhe po ashtu ta zvarriste këtë proces. Ftohtësia me të cilën Luckwald-i e trajtoi këtë çështje gjatë bisedave me palën shqiptare, si edhe mungesa e fondeve të qeverisë shqiptare për të hapur legatën, bënë të mundur që deri në vitin 1936 të mos kishte asnjë zhvillim konkret në lidhje me këtë problem.

Me krijimin e të ashtuquajturit «kabineti gjerman», në vitin 1936, me kryeministër Mehdi Frashërin, Mbreti Zog shpresonte që nëpërmjet rigjallërimit të aktivitetit politik me Gjermaninë, të arrinte një balancim të marrëdhënieve shqiptaro-italiane. Tendencat e qeverisë shqiptare për hapjen e përfaqësive diplomatike pranë Fuqive Qendrore me rezidencë

9 PA/AA, R 72443. Raport i Konsullatës gjermane në Tiranë, datë 15 shkurt 1934, drejtuar Ministrisë së Jashtme Berlin për hapjen e Legatës shqiptare në Berlin.

10 PA/AA R 72443, Dokument Nr. 437, datë 13 mars 1934. Letër e drejtorit në Ministrinë e Jashtme Köpke drejtuar ministrit Luckwald.

kryesore në Berlin morën në Majin e vitit 1936 një formë më të plotë. Për këtë gjë tashmë ishte marrë edhe miratimi i Parlamentit. Në të njëjtën kohë, Ministria e Jashtme shqiptare kërkoi nga qeveria gjermane dhënien e *agreement*-it për Eqrem Vlorën, i cili do të drejtonte këtë përfaqësi.¹¹

Por, lufta klanore pranë mbretit Zog do të bëhej përsëri pengesë për realizimin e këtij projekti. Pavarësisht se qeveria gjermane kishte dhënë pëlqimin për Eqrem Vlorën, Zogu kishte ndërruar përsëri mendje dhe shikonte ish Ministrin e Kulturës Nush Bushati si kandidaturën më të përshtatshëm për ta dërguar në Berlin. Kjo gjë mund edhe të kishte funksionuar nëse ministri gjerman në Tiranë nuk do të kishte pasur rezerva ndaj personit të Bushatit për shkak të së kaluarës së tij në Vjenë, si sekretar i Fan Nolit. Rezervat e gjermanëve ndaj Bushatit kishin më tepër karakter moral sesa politik.¹² Këto vonesa i vinin për shtat qeverisë gjermane.

Përfundimisht në gusht të vitit 1938, qeveria shqiptare emëroi Rauf Ficon si të Dërguarin e Jashtëzakonshëm dhe Ministër Fuqiplotë në krye të Legatës shqiptare të sapo hapur në Berlin.

Jetëgjatësia e përfaqësisë diplomatike shqiptare në Berlin ishte tepër e shkurtër. Si pasojë e ndryshimeve statutore që do të pësonte Shqipëria si pjesë e *Unionit Personal*, diplomacia shqiptare do të drejtohej tashmë nga Roma dhe më 6 qershor 1939, R. Fico njoftoi Ministrin e Jashtëm gjerman Ribbentrop-in për mbylljen e përfaqësisë diplomatike shqiptare në Berlin.

Arkivi Federal – Bundesarchiv

Siç e theksuam edhe më sipër, dokumentacioni kryesor për historinë e Shqipërisë deri në fundin e Luftës së dytë Botërore gjendet kryesisht në Arkivin Politik dhe në Arkivin Ushtarak të Freiburg-ut. Arkivi Federal është i ndarë në tetë filiale. Selia kryesore e Arkivit Federal është në Koblenz. Ndonëse i krijuar në vitin 1952, mbi një koncept provizor dhe si pasojë e afërsisë me qytetin e Bonn-it, Koblenzi u konfirmua si qendra e Arkivit Federal në vitin 1986, kur ish-Kancelari Helmut Kohl inauguroi godinën e re moderne të arkivit.¹³ Në magazinat prej afro 15.000 m² ruhen para së gjithash fondet e Departamentit B (*Republika Federale Gjermane*). Kësisoj, në këtë arkiv ruhet edhe dokumentacioni i krijuar për Shqipërinë, së pari pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike ndërmjet republikës Federale Gjermane dhe Shqipërisë në vitin 1987.

Filiali tjetër i Arkivit Federal në të cilin ruhen dokumente për Shqipërinë

11 PA/AA, ADG Tirana, PIII, kartoni 1, Raport Nr. 806, datë 10 tetor 1936, Luckwald për Auswärtiges Amt-in.

12 PA/AA, Akten der deutschen Gesandtschaft Tirana, PIII, kartoni 1, Raport Nr. 409, datë 7 qershor 1937.

13 <http://www.bundesarchiv.de/bundesarchiv/dienstorte/koblenz/index.html.de>, 29.11.2017.

është në Berlin Lichterfelde. Dokumentacioni për Shqipërinë mund të konsultohet në fondet e Departamentit të Rajhut Gjerman, të Republikës Demokratike Gjermane dhe të Partisë Nationalsocialiste. Konkretisht, deri në vitin 1945 fondet kryesore janë: R 901 Ministria e jashtme, NS 43 zyra e Politikës së Jashtme e Partisë Nationalsocialiste, NS 19 Shtabi personal i Himmler-it (Reichsführer SS), R 3101 Ministria e Ekonomisë së Rajhut, R 2 Ministria e Financave të Rajhut, R 4901 Ministria e Shkencës, Edukimit dhe Arsimit Popullor të Rajhut, R 43 Kancelaria e Rajhut, R 1501 Ministria e Brendshme e Rajhut dhe R 55 Instituti Gjerman për Vendet e Huaja. Dokumentacioni i pas vitit 1945 është i trashëguar nga Republika Demokratike Gjermane. Duke pasur parasysh faktin se, me Gjermaninë Lindore Shqipëria nuk i ndërpreu marrëdhëniet diplomatike, rrjedhimisht edhe dokumentacioni për Shqipërinë është më voluminoz sesa ai i krijuar në Gjermaninë Perëndimore. Fondet kryesore janë DC 20 Këshilli i Ministrave të DDR-së, DA 5 – Këshilli i Shtetit të DDR-së, DA 1 Kuvendi Popullor i DDR-së, DD 1 Ministria e Punëve të Jashtme – arkivi i shtypit, DY 30 Partia Socialiste Gjermane dhe DY 24 Rinia e Lirë Gjermane.

Në veçanti me interes në këtë arkiv paraqitet dokumentacioni i hartuar për Shqipërinë e viteve 1913-1914, kur Fuqitë e Mëdha zgjodhën princin gjerman Wilhelm zu Wied në krye të principatës shqiptare dhe e dërguan atë në Shqipëri. Këtu vlejme të përmendim një fond me artikuj të mbledhur të gazetave gjermane në vitet 1913-1914, të cilat hedhin dritë jo vetëm mbi mënyrën e zgjedhjes së princit gjermanë në krye të shtetit të ri shqiptar por po ashtu, reportazhet e hartuara nga gazetarët gjermanë që kishin ardhur në Shqipëri, janë një burim i paçmuar historik për situatën në Shqipëri në këtë kohë, për kryengritjen ndaj Wied-it si edhe për vlerësimet e personazheve historikë të kohës.

Ajo që bie në sy në këtë dokumentacion, është konsultimi i një sërë burimesh arkivore të panjohura më parë. Një të tillë po e japim më poshtë:

Në dhjetor të vitit 1913, dy oficerë, Kapiteni austriak Ulmansky dhe ai gjerman Clanner, të urdhëruar nga Shtabi i Përgjithshëm austro-hungarez, kryen një vizitë disa javore në Shqipëri. Kapiten Ulmansky vizitoi qytetet e Shkodrës, Lezhës, Durrësit, Tiranës dhe Pogradecit, ndërkohë që Kapiteni Clanner vizitoi Jugun e Shqipërisë. Raporti që ata hartuan mbi vizitën e tyre në Shqipëri është jo vetëm tepër i hollësishëm, por po ashtu të krijon bindjen e një analize të thellë dhe të kujdesshme për gjendjen e shoqërisë shqiptare në prag të ardhjes së Wied-it, si edhe për situatën politike, ekonomike dhe ushtarake të Shqipërisë. Po ashtu raporti duhet të shërbente si një udhëzues për Wied-in.¹⁴

Ulmansky në raportin e tij e klasifikonte shoqërinë shqiptare në

14 B Arch R901/901, *Militärbericht Nr. 9, „Ein Bericht über Albanien“, Wien 2. Februar 1914, Deutsche Botschaft Wien, Büro des Militärattaches.*

katër grupime kryesore dhe konkretisht, në shtresën e kulturuar dhe të arsimuar elitare të vendit, në bejlerët e fshatit, në elementë të kulturuar, që kishin jetuar në Europë, por që ishin me prejardhje nga shtresat e ulëta të shoqërisë dhe nga pjesa tjetër e popullit, ç'ka përbënte edhe shumicën e tij dhe që ishte analfabete. Cilat ishin tiparet e këtyre grupimeve sipas Kapiten Ulmanky-t?

Shtresa elitare e vendit; e cila ishte në kontakt me kulturën evropiane ose që kishte shërbyer në aparatën shtetëror gjatë sundimit turk. Në këtë kategori kishte vetëm pak elementë të vlefshëm që mund t'i shërbenin Wied-it. Xhelozia e tyre ndaj njëri-tjetrit, ambiciet për pushtet, nder dhe para do t'i shkaktonin probleme të mëdha Princit. Prandaj, ishte në interes të tij dhe të vendit, që së pari të kufizohej pushteti efektiv i këtyre elementëve. Shumica e kësaj shtrese kishte koncepte etnike shumë të ngatërruara. Madje, disa koncepte të tyre, mund të konsiderohen edhe si të pamoralshme- shkruan Ulmanky. Gjithsesi, në këtë kategori kishte elementë të mirë dhe me vlera, të cilët mund të përdroreshin në pozicione drejtuese të administratës.

Bejlerët që jetojnë në fshat; pjesa më e madhe e tyre nuk mund të merrej në administratë sepse ishin analfabetë. Por, një pjesë e tyre që ishte e arsimuar, mund të krijonte një bazë të fuqishme mbështetëse për qeverinë e re. Në një farë mënyre ishte e nevojshme të ngarkoheshin me punë edhe të paarsimuarit e kësaj shtrese. Ndoshta duke shfrytëzuar inteligjencën e tyre natyrore, si edhe dëshirën për të bashkëpunuar, mund të bëhej e mundur që brenda një kohe të shkurtër ata të ushtronin funksione administrative.

Elementët që rridhnin nga populli i thjeshtë, që kishin jetuar në Europë dhe e njihnin kulturën evropiane. Po ashtu si një pjesë e shtresës elitare të vendit, edhe nga kjo shtresë, disa prej tyre, gjatë jetës në Europë kishin shijuar kënaqësinë e rremë të kulturës evropiane dhe si pasojë po ashtu kishin koncepte etnike të ngatërruara. Por, një pjesë e tyre zotëronte një arsimim të vërtetë dhe ata mund të përbënin një mbështetje shumë të fortë për qeverinë.

Pjesa më e madhe e popullit, gjendej në një prapambetje shekullore dhe ishte e nevojshme që me ta të ndiqej një edukim kulturor gradual. Nëse do të tentohej të përshpejtohej procesi i kulturimit të tyre - argumentonte më tej Ulmanky - mund të kishte pasoja fatale. Por, nëse do të ngrihej një regjim i bazuar në rregulla, i fuqishëm dhe i drejtë, atëherë zhvillimi kulturor në vetvete do të përshpejtohej dhe njerëzit shumë shpejt do të shndërroheshin në qytetarë të bindur dhe të nënshtruar. Por, nëse fuqia shprehëse e pushtetit do të mungonte - ç'ka edhe ndodhi - atëherë ata nuk do të bindeshin më.

Më tej Ulmanky raportonte që: *“Në përgjithësi shqiptarët janë të shëndetshëm, gëzojnë një inteligjencë natyrore, nuk janë aspak të mësuar me*

*punën dhe si fizikisht ashtu edhe mendërisht, janë dukshëm joaktivë. Prirja e tyre ndaj mizorive nga njëra anë, dhe përkushtimi i tyre deri në flijim për miqtë nga ana tjetër, janë tashmë pothuajse të njohura. Por, nuk e besoj që ky popull ta gjejë vetë rrugën e kulturës duke u drejtuar vetëm nga disa elementë të pranishëm të kulturuar”.*¹⁵

Po ashtu, Ulmanky raportonte se partikularizmi i organizimit shtetëror në Shqipëri në vitet 1913-1914 ishte i dukshëm. Në vend vepronin paralelisht me njëra tjetrën disa qeveri lokale. Në Shkodër drejtonte qeveria e detashmentit ndërkombëtar. Ajo kishte në dispozicion mjetet e duhura dhe të nevojshme për të ushtruar pushtetin e saj dhe brenda territorit të saj kishte arritur të vendoste disa marrëdhënie të rregullta. Pavarësisht masave të forta policore, siguria njerëzore ishte akoma tepër problematike. Ulmanky shkruan, se një natë para se ai të mbërrinte në Shkodër, disa malësorë të armatosur kishin hyrë në qytet për të marrë gjak dhe kishin vrarë shtatë persona.

Qeveria ndërkombëtare kishte emëruar vendas në poste administrative dhe mundahej të organizonte armën e xhandarmërisë. Funksionimi i qeverisë ndërkombëtare ishte në radhë të parë meritë e koloneli anglez Phillips. Ndërkohë që në kohën e këshillit të admiralitetit, çdo çështje administrative shndërrohej në një çështje potence për çdonjërin shtet nga Fuqitë e Mëdha, koloneli Phillips, si ushtarak, nuk ngatërrohej me çështjet politike dhe përqendrohej në kryerjen sa më mirë të punës së qeverisë që ai drejtonte.

Në Lezhë qeveriste Ded Coku. Sidoqoftë, pushteti i tij mund të quhej qeverisje vetëm për faktin se ai nuk pranonte këshilla dhe urdhra prej askujt dhe bënte çfarë dëshironte në territorin e tij. Në këtë distrikt, nuk bëhej fjalë për ekzistencën e një administrate. Po ashtu, edhe në Mirditë dhe në Malësi, mbizotëronte i njëjti organizim. Bajraktarët dhe kryetarët e fiseve drejtonin njerëzit e tyre në mënyrë të pavarur. Pjesa më e madhe e Mirditës drejtohej nga Preng Bib Doda. Sipas Ulmanky-t, në pikëpamje të rregullit, qetësisë dhe sigurisë, këto ishin edhe territoret më të rrezikshme në gjithë Shqipërinë. Gjithashtu në viset shqiptare në kufi me Serbinë dhe Malin e Zi ndihej edhe ndikimi i propagandës serbe.

Qeveria e Esat Pashës në Durrës mund të konsiderohej si e vetmja qeveri autoktone shqiptare, e cila ishte vërtet në gjendje të qeveriste. Nëpërmjet organeve përkatëse Esat Pasha ishte në gjendje të mblidhte taksat, filloi të ndërtonte rrugë, krijoi një xhandarmëri të disiplinuar dhe emëroi në vendet më të rëndësishme nëpunës që ndiqnin dhe zbatonin urdhrat e tij. *“Në territorin e zotërimit të tij, të krijohej përshtypja e një sundimi ushtarak dhe kudo vihej re një farë rregulli i tillë”,* theksonte Ulmanky.¹⁶

15 B Arch R901/901, Militärbericht Nr. 9, „Ein Bericht über Albanien“.

16 Po aty.

Marrëdhëniet e Esat Pashës me qeveritë e tjera ishin shumë të këqija. Po ashtu edhe popullsia vendase nuk ishte e kënaqur me qeverisjen e Esat Pashës si pasojë e dhunës qeverisëse që ai ushtronte ndaj tyre.

Qeveria e Aqif Pashës në Elbasan ushqente marrëdhënie të mira me qeverinë e Vlorës por, gjithsesi, pa dashur të bëhej pjesë e saj. Kjo qeveri e ruante pushtetin e saj nëpërmjet xhandarmërisë, e cila ishte e organizuar dhe armatosur mirë. Po ashtu, edhe qeveria e Omer Pashë Vrionit në Fier kishte thuar se të njëjtën rëndësi dhe ishte e organizuar si qeveria e Elbasanit.

Qeveria e Ismail Qemalit në Vlorë, në ndryshim nga qeveritë e tjera lokale shqiptare, ishte më e veçantë. Ajo konsiderohej si qeveria zyrtare e Shqipërisë dhe po ashtu mbante lidhjet diplomatike me qeveritë evropiane. Në të vërtetë, ndikimi i saj shtrihej vetëm në qytetin e Vlorës dhe në territoret e afërta të qytetit.

Qeveria kishte xhandarmërinë e saj dhe, në ndryshim nga qeveritë e tjera lokale shqiptare, kishte krijuar edhe ushtrinë e saj. Kraheluar me qeveritë e tjera lokale, qeveria e Vlorës kishte të ardhurat më të mira, si pasojë e vjeljes së taksave portuale. Me gjithë partikularizmin politik dhe mungesën e një qeverisje të centralizuar të vendit shkaktonte probleme të shumta. Në brendësi të vendit mbizotëronte një farë qetësie dhe rregulli dhe të huajt mund të udhëtonin pa probleme. Po ashtu, shërbimi postar dhe ai telegrafik funksiononte në gjithë vendin.

Një nga përfundimet e arritura nga Ulmanky për organizmin dhe të ardhmen politike të Shqipërisë ishte që, në këto kushte, Shqipëria mund të arrinte të siguronte ekzistencën e saj vetëm nën sundimin e një përfaqësuesi të huaj.¹⁷ Në fakt, po t'i referohemi ngjarjeve të këtyre viteve, të këtij mendimi ishin edhe shumë patriotë shqiptarë.

Riorganizimi i marrëdhënieve politike do të përbënte edhe detyrën më të vështirë që do të kishte Wied-i sapo të kishte formuar qeverinë e tij. Ndër kryetarët e qeverive lokale që u përmenden më sipër, Ismail Qemali dhe Esat Pasha ishin më të rëndësishmit. Po ashtu këta ishin të vetmit që mund të bënin rezistencë ndaj Wied-it.

Ismail Qemali bënte pjese të patriotët e sipër përmendur shqiptarë, i cili, në situatën e vështirë që po kalonte vendi, e shikonte të ardhmen e Shqipërisë të siguar vetëm nën tutelën e Fuqive të Mëdha dhe të një Princi të huaj.

Me Esat Pashën qëndronte puna ndryshe. Ai e pranoi ardhjen e Princ Wied-it vetëm pas ndërhyrjes së Kontrollit Ndërkombëtar të Komisionit.

Si Ismail Qemali ashtu edhe Esat Pasha trembeshin se mos Wied-i zgjidhte tjetrin për t'u mbështetur pas tij, ç'ka edhe e shprehnin hapur. Për të mos u bërë pre e këtyre armiqësive, Ulmanky, e këshillonte Wied-

17 B Arch R901/901, Militärbericht Nr. 9, „Ein Bericht über Albanien“.

in të zgjidhte ndërmjet dy mundësive. E para, gjithë kryetarët e qeverive aktuale t'i emëronte si drejtues të administratës lokale të zonave që ata kishin nën administrim deri në momentin e ardhjes së tij në Shqipëri dhe, me ndihmën e tyre, të krijonte qeverinë e re, ose e dyta dhe mundësia më e pranueshme për kushtet shqiptare, t'i emëronte këta persona në detyra të larta, por që të mos kishin ndikim mbi organizimin shtetëror. Kështu për shembull, Ismail Qemalin ta dërgonte si ambasador në Londër, ndërsa Esat Pashën ta titullonte komandant të oborrit të tij.¹⁸

Zgjidhja e Ulmanky-t ishte interesante, por gjithsesi shumë e varfër për shijet dhe ambiciet e Esat Pashës. Ngjarjet do të tregonin se ai nuk ishte i kënaqur me postin e Ministrit, dhe jo më të një komandanti oborri.

Në prag të ardhjes së Wied-it në Shqipëri, vetëm qeveria e Vlorës kishte një forcë ushtarake, me një Ministri Lufte si edhe një Shtab Madhor që drejtonte ushtrinë, e cila gjithsesi ishte në fazën e saj të formatimit. Megjithatë, kjo forcë ushtarake qëndronte nga pikëpamja organizative më pranë armës së xhandarmërisë sesa të një Ushtrie, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës.

Sipas Ulmanky-t, numri i përgjithshëm i xhandarëve të gjithë qeverive lokale së bashku, ishte rreth 2000 burra.¹⁹ Mosha e tyre shkonte deri në 40 vjeç. Ata ishin të armatosur me mauzerë të prodhimit turk, shumica e të cilëve ishin ruajtur që nga koha e shërbimit në ushtrinë turke. Por, ndërmjet tyre, kishte diferenca shumë të mëdha në pikëpamje të stërvitjes, përgatitjes dhe të perceptimit të tyre ndaj shërbimit. Për këtë arsye, kjo forcë xhandarmërie nuk mund të përdorej nga Wied-i si një forcë ushtarake e unifikuar.

Përfundimisht mund të thuhet që, bazuar në problemet e shumta të vendit dhe mungesën e një aparati shtetëror, zhvillimi i vendit mund të bëhej vetëm me hapa të vegjël dhe në mënyrë graduale. Pengesa kryesore për zhvillimin e Shqipërisë ishin vetë Fuqitë e Mëdha. Shqipëria vazhdonte të ishte fushëbeteja e diplomacisë evropiane. Kjo sjellje e dëmtonte shumë Shqipërinë dhe po ashtu demoralizonte tërësisht inteligjencën shqiptare.

Në këtë kuadër, një rëndësi të veçantë përbënte sjellja e Princit dhe politika e jashtme që ai do të ndiqte. Nëse ai vërtet kishte ndërmend të qeveriste dhe të punonte për t'u ofruar shqiptarëve një sistem të rregullt shtetëror, atëherë atij i duhej të luftonte kundër problemeve të mësipërme dhe të krijonte për popullin shqiptar përshtypjen e një sovranit jo vetëm brenda Shqipërisë por edhe jashtë kufijve të Shqipërisë.

Po ashtu, Wied-it do t'i duhej të harxhonte shumë energji në përpunimin e mentalitetit shqiptar. Sfidë kryesore në këtë drejtim ishte që, Wied-i duhej të bindte shqiptarët se, *"së pari, çdo shtetas i aftë për të punuar duhet të japë*

18 B Arch R901/901, Militärbericht Nr. 9, „Ein Bericht über Albanien“.

19 Po aty.

kontributin e tij për mbarëvajtjen e vendit (dhe jo ta mbaje shteti atë).Së dyti, puna dhe koha janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën dhe puna ka vlerë vetëm nëse bëhet në kohën e duhur dhe së treti, njeriu është gjëja më me vlerë e shtetit. Vetëm nëse janë përmbushur këto tre parime kryesore, mund të thuhet se kemi të bëjmë me një shtet kulturor edhe në rastin e Shqipërisë”²⁰, përfundonte raportin e tij Ulmansky.

Arkivi ushtarak Freiburg – Bundesarchiv Militärarchiv Freiburg

Një arkiv tjetër i rëndësishëm ku ruhen dokumente për Shqipërinë gjatë Luftës së Dytë Botërore është Arkivi Ushtarak në Freiburg (Militärarchiv – BA MA). Ky arkiv është një nga departamentet e Arkivit Federal dhe është i vendosur në Freiburg in Bresgau, në jug të Gjermanisë.

BA MA është përgjegjës për ruajtjen e fondeve arkivore dhe dokumenteve të Ministrisë Federale të Mbrojtjes, Forcave të Armatosura dhe administratës së Bundeswehr-it. Në këtë arkiv ruhen edhe dokumentet e trashëguara nga Wehrmacht-i, Arma-SS, Forcat Ajrore e Detare, ku gjendet edhe dokumentacioni për periudhën 15-mujore të pushtimit të Shqipërisë nga Gjermania Nationalsocialiste. Fondet arkivore për kohën deri në vitin 1945 kanë pësuar shumë dëmtime nga lufta. Më të prekurat janë fondet e zyrave qendrore të Wehrmacht-it dhe Komandës së Forcave Tokësore, si edhe të forcave ajrore dhe detare. Nga ky dëmtim nuk shpëtoi as dokumentacioni për Shqipërinë. Gjatë tërheqjes së forcave të divizionit 297 të këmbësisë së Wehrmacht-it nga Tirana më 17 nëntor 1944, makina ku ishte grumbulluar dokumentacioni luftarak i komandës së divizionit u godit nga partizanët dhe mori flakë, duke u djegur së bashku me dokumentacionin plotësisht.

Në këtë arkiv gjendet një sasi relativisht e konsiderueshme dokumentacioni, rreth 100 fonde arkivore, që flasin për Shqipërinë në vitet 1943-1944. Dokumentacioni ruhet i ndarë kryesisht në fondin e Komandës së Lartë të Forcave Tokësore të Europës Juglindore, të Grupimit të Forcave Tokësore F dhe E, të Komandës së Lartë të Armatës së Dytë Tankiste, të Korparmatës së 21-të Malore, të Divizionit 100 alpin, të Divizionit 181 dhe 297 të këmbësisë, të divizionit 21 –SS (divizioni SS - Skanderbeg), të komandantit të forcave territoriale të Europës Juglindore dhe komandës fushore 1041 etj. Po ashtu, edhe në fondet e ushtrisë gjermane për vendet fqinje, kryesisht në ato të dislokuara në Greqi, mund të konsultohet dokumentacion me vlerë për Shqipërinë, e sidomos për Çamërinë dhe problemin çam gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Në këtë dokumentacion voluminoz, i cili hedh dritë jo vetëm për masat ushtarake që mori Wehrmacht-i gjerman, politikës së ndjekur ndaj Shqipërisë, marrëdhëniet me shqiptarët, por edhe konfliktet dhe

20 Po aty.

mosmarrëveshjet ndërmjet shqiptarëve etj., në fondin RS 3-21/1 gjejmë të dhëna edhe për krijimin e divizionit SS-Skanderbeg në Kosovë, të cilat vlejnë t'i sjellim shkurtimisht në këtë kumtesë.

Ideja e krijimit të Divizionit – SS “Skanderbeg” (21. Waffen-Gebirgs-Division der SS “Skanderbeg” ose Albanische Nr. 1), bazohej në prioritetin e qeverisë Mitrovica për krijimin e një force ushtarake shqiptare, e cila do të ruante qeverinë, do të luftonte komunistët dhe pa dyshim, do të lehtësonte edhe forcat e Wehrmacht-it gjatë kryerjes së detyrës së tyre luftarake në Shqipëri.

Mendimi për krijimin e kësaj force u hodh menjëherë pas pushtimit gjerman të Shqipërisë, por u ndërpre përkohësisht si pasojë e propagandës gjermane dhe këmbënguljes së Neubacher-it për të ruajtur në dukje pavarësinë shqiptare por, edhe si pasojë e kontradiktave, të “përplasjes së kompetencave” ndërmjet instancave ushtarake gjermane në Shqipëri.

Në fillim të vitit 1944, pasi u pa qartë se qeveria shqiptare dështoi në ngritjen e një force ushtarake qeveritare, trupa që për gjermanët tani ishin tepër të nevojshme në luftën kundër partizanëve, Hitler-i miratoi krijimin e Divizionit – SS “Skanderbeg”.

Qeveria shqiptare mori përsipër nxjerrjen e një urdhri, sipas së cilit, në Kosovë do të kryhej rekrutimi i burrave të lindur në vitet 1920 deri 1924. Për rekrutimin e shqiptarëve ishte e interesuar edhe “Lidhja e Dytë e Prizrenit”. Kryetari i Lidhjes, Bedri Pejani, i cili më vonë do të zëvendësohej nga Xhaferr Deva, i shkroi një letër Hitler-it, ku ndër të tjera i kërkonte armatim për 150.000 burra.

I parë në pikëpamje ushtarake dhe organizative, urdhri për krijimin e këtij Divizioni ishte vlerësuar mbi kërkesa të gabuara. Shqiptarët nuk kishin pasur asnjëherë trupa të organizuara ushtarake sipas perceptimit gjerman për një forcë të rregullt ushtarake. Njësitë ushtarake shqiptare të deriatëhershme, përfshirë edhe milicinë shqiptare të krijuar gjatë pushtimit italian, paraqisnin vetëm një krijesë ushtarake në dukje. Atyre u mungonte çdo strukturë e brendshme solide ushtarake. Mangësia e parë kryesore e këtyre trupave ishte mungesa e disiplinës, të cilën ushtarakët italianët jo vetëm që nuk u munduan ta përmirësojnë, por përkundrazi e kultivuan më tej atë.

Divizioni “Skanderbeg” veproi kryesisht në rajonin kufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi. Ai mori pjesë në disa operacione kundër partizanëve.

Përfundimisht vlen të theksohet se, krijimi i Divizionit SS “Skanderbeg” nuk përbënte ndonjë rast të veçantë apo tipar dallues të marrëdhënieve pushtuese, politike dhe ushtarake ndërmjet Gjermanisë dhe Shqipërisë. Kjo për shkak se gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore, Gjermania rekrutoi nën Armën-SS shumë ushtarë apo njësi e reparte të tjera nga

shtete të huaja në tërë hapësirën e paanë të pushtimit dhe jo vetëm në Ballkan por thuajse në gjithë vendet që ajo pushtoi. Në këtë kuadër, edhe në Ballkan u rekrutuan forca të tilla, si në Shqipëri, Bosnje, Kroaci, Bullgari etj.

Krijimi i Divizionit “Skanderbeg” i shërbente më së shumti gjermanëve, por edhe qeverive kolaboracioniste shqiptare. Gjermanët i përdorën forcat e Divizionit shqiptar në terriore të largëta për qeverinë e Tiranës, kryesisht në Kosovë, dhe ata nuk mundën thuajse asnjëherë ti shërbenin vërtet drejtpërdrejt qeverisë së Tiranës brenda Shqipërisë shtetërore.

Përfundime

Në arkivat gjermane, dokumentacioni i mbledhur dhe i ruajtur për Shqipërinë është i hapur dhe i konsultueshëm nga gjithë studiuesit. Ky dokumentacion është kryesisht në gjuhën gjermane, e më pak në atë shqipe apo në ndonjë gjuhë tjetër, si në gjuhën franceze dhe italiane. Ky dokumentacion është thuajse i deklasifikuar dhe, vetëm një pjesë e tij, kryesisht dokumentacioni që është prodhuar pas vitit 1991, ende nuk është i hapur. Pjesa tjetër, duke filluar qysh në fund të shekullit XIX e deri në vitet 1990, mund të konsultohet lehtësisht në ambientet e arkivave gjermane.

Një lehtësim në përdorimin e fondeve arkivore të këtyre arkivave përbën kërkimi elektronik në internet si edhe në sallën e leximit në ambientet e secilit arkiv, siç janë makinat e kërkimit *Invenio* dhe *Argus*. Kjo formë kërkimi jo vetëm që mundëson gjetjen e plotë të dokumentacionit, por po ashtu lejon mundësi të mira përgatitore për qëndrimin dhe punën në arkiv. Tepër ndihmuese dhe favorizuese është edhe mënyra e qartë e ndarjes dhe krijimit të fondeve arkivore. Kjo gjë pasqyrohet qysh në ndarjen e fondeve arkivore sipas tematikave dhe institucioneve përkatëse, të cilët janë edhe fondkrijuesit, pavarësisht ndryshimeve strukturore shtetërore ndër vite. Nga ana tjetër, vendosja e filialeve të Arkivit Federal në qytete të ndryshme, e vështirëson punën dhe qëndrimin, sidomos për studiuesit e huaj. Kësisoj, nëse një studiues shqiptar dëshiron të konsultojë dokumentacionin për Shqipërinë e Luftës së Dytë Botërore duhet të shkojë në Freiburg, në Arkivin Ushtarak, por edhe në Berlin-Lichterfelde në filialin e Arkivit Federal dhe sigurisht edhe në Arkivin Politik të Auswärtiges Amt-it, po në Berlin. Nga ana tjetër, nëse synohet të shikohen edhe imazhe filmike, apo fotografike të kësaj periudhe, duhet të shkohet në arkivin e Berlin-Wilmersdorf-it. Më tej, nëse kërkohet që studimi i materialeve arkivore të shtrihet edhe mbi krimet e Nacionalsocializmit në periudhën shtator 1943 – nëntor 1944, atëherë duhet që të konsultohen fondet arkivore në arkivin për zbulimin e krimeve të Nacionalsocializmit në Ludwigsburg.

Nga konsultimi i thuajse gjithë fondeve të arkivave gjermanë për dokumentacionin që hedh dritë mbi historinë e Shqipërisë, arrijmë në

përfundimin se, natyra e këtij dokumentacioni është tepër e veçantë. Së pari, për periudhën 1900-1943, duke pasur parasysh faktin se Gjermania nuk ka pasur ndonjë interes të drejtpërdrejtë ndaj Shqipërisë, në dokumentacionin arkivor mbizotëron fryma e “shkrimit të ftohtë” të dokumentit. Kësisoj, sot mund të flasim për interpretime dhe vlerësime të situatës politike, ekonomike, ushtarake dhe shoqërore nga “një i tretë i paanshëm”. Parë në këtë këndvështrim, ky dokumentacion merr një vlerë të veçantë sidomos për periudhën e presidencës, por edhe mbretërisë së Ahmet Zogut. Po kaq me vlerë paraqitet edhe dokumentacioni i hartuar në periudhën gjashtë mujore të qeverisjes së Princ Wied-it në Shqipëri. Shembulli i sjellë në këtë kumtesë, është një tregues i mirë i cilësisë së këtij dokumentacioni. Së dyti, dokumentacioni arkivor i krijuar gjatë pushtimit gjerman të Shqipërisë, 1943-1944. Duke pasur parasysh natyrën e këtij dokumentacioni, kryesisht me origjinë ushtarake, në formë vlerësimesh të situatës politike dhe ushtarake të Shqipërisë, si psh. vlerësime të politikës shqiptare, vlerësime për qëndrimin e shqiptarëve ndaj tyre, por edhe ndaj njëri-tjetrit, aleancat me ta por edhe duke dhënë të dhëna për kundërshtarët si edhe krijimin e pamje të përgjithshme të gjithë teatrit ballkanik të luftës, mundëson një vlerësim më gjithëpërfshirës së historisë së Shqipërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Një dimension tjetër i rëndësishëm i këtij dokumentacioni është edhe natyra e tij në pikëpamje të metodologjisë dhe vlerësimit të burimeve në shkencat historike: ky dokumentacion vjen te ne sot në trajtën e burimeve historike të trashëguara dhe që në momentin e hartimit të tyre nuk janë shkruar për të na treguar ne atë realitet të shkuar, por që pikësepari i shërbente punës së tyre.